

**Demokracia dhe siguria e njeriut: Lidhje e  
agjendave lokale dhe e agjendës së  
Ballkanit Perendimor**

Shkup, 2009

Botues:  
Friedrich-Ebert-Stiftung  
Zyra Shkup – Maqedoni  
www.fes.org.mk

Përgaditja kompjutorike:  
Promo DSGN, Skopje

Lektura: Ismet Bitik

Tirazh:  
200

Copyright: Friedrich Ebert Stiftung

CIP – Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

355.45(062)  
327.36.(497-15)(062)

DEMOKRACIA dhe siguria e njeriut : lidhje e agjendave lokale e agjendës së  
Ballkanit perendimor. – Skopje : Fondacija “Fridrih Ebert”, Kancelarija Skopje, 2009. – 34  
стр. ; 24 см

Shënimet përfundimtare: стр. 30-34

ISBN 978-9989-109-51-5

а) Национална безбедност – Собири б) Меѓународна безбедност – Западен Балкан –  
Собири  
COBISS.MK – ID 80781834

## **PERMBAJTJA**

Punëtori dhe konferencë	5
<b>Demokracia dhe siguria e njeriut: Lidhje e agjendave lokale dhe agjendës të Ballkanit Perëndimor</b>	
<b>Parandalimi dhe siguria njerëzore: Sfidat dhe mundësitë e Republikës së Maqedonisë dhe vendeve tjera të Ballkanit perëndimor në aspekt të afrimit drejt Bashkimit Evropian</b>	7
Jovan Tegovski	
<b>Parandalimi dhe siguria njerëzore: Drejt agjendës së përbashkët</b>	12
Трпе Стојановски	
<b>Dimensioni parlamentar i parandalimit dhe siguria njerëzore</b>	16
Petra Bläss-Rafajlovski	
<b>Përmbledhje e konstatimeve të punëtorisë "Parandalimi dhe siguria njerëzore - integrimi i agjendave të brendshme dhe të jashtme"</b>	23
Tome Sandevski	
<b>Demokracia dhe siguria njerëzore Integrimi i Ballkanit Perëndimor dhe agjenda lokale politike</b>	26
Lidija Georgieva	
<b>Shënimet përfundimtare</b>	30



## **Fondacioni Fridrih Ebert**

Punëtori dhe konferencë

### **Demokracia dhe siguria e njeriut:**

### **Lidhje e agjendave lokale dhe agjendës të Ballkanit Perendimor**

13 -14 Nëntor 2008

Shkup, Republika e Maqedonisë

Fondacioni Fridrih Ebert dhe Qendra për Parandalim dhe vlera evropiane në vitin 2004 e filloi projektin e quajtur *Partnerë në paqe dhe Parandalim*, i cili kishte për qëllim të mbështesë dhe të nxisë më tej paqen, si vlerë demokratike, si dhe parandalimin, si normë, politikë dhe instrument konstruktiv për forcimin e proceseve demokratike, paqen dhe sigurinë në Republikën e Maqedonisë.

Kjo konferencë është pjesë e këtij projekti ku avancimi i mundësive në shoqërinë e Maqedonisë që lejojnë forcimin e vlerave të përbashkëta, zhvillimin e qetë dhe të qëndrueshëm dhe me të cilët nxisin politika demokratike dhe konstruktive dhe instrumente për zgjidhjen e problemeve, janë parakushte për forcimin e prosperitetin dhe proceseve të përgjithshme integrative në Republika e Maqedonisë. Promovimi i tyre është objektivi kryesor i këtij projekti.

Parandalimi si një parim dhe politikë dhe siguria njerëzore si një koncept përmes të cilëve aktualizohen nevojat e qytetarëve, gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë të proceseve aktuale në rajon dhe bashkësisë më të gjerë ndërkombëtare, si dhe të proceseve aktuale në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi i këtij seminari ishte që të hapen dhe jepen përgjigje për pyetjet:

- Si, sa dhe në çfarë mënyrë parandalimi dhe siguria e njeriut janë pjesë e proceseve integruese në Republikën e Maqedonisë;
- Cilat janë parimet bazë dhe vlerat e përbashkëta rreth të cilave pjesëmarrësit mund t'i krijojnë pozicionet e tyre;
- Normat e parandalimit dhe sigurisë njerëzore si mund të implementohen në politikën dhe aktivitetet e institucioneve të ndryshme të nivelit shtetëror dhe lokal;
- Cilat janë pritjet dhe rezultatet e politikës parandaluese?

Kjo ngjarje zgjati dy ditë: ditën e parë ishte punëtori e organizuar për një grup më të vogël të pjesëmarrësve (përfaqësues të ministrive, akademikë dhe ekspertë), të cilët i diskutuan këto aspekte, si vijon:

1. Parandalimi dhe Siguria Njerëzore: Integrimi i agjendës së brendshme dhe të jashtme
2. Dimensioi lokal i parandalimit dhe sigurisë njerëzore
3. Dimensioi parlamentar i parandalimit dhe sigurisë njerëzore.

Këto tema janë diskutuar në seminare të veçanta, rezultatet e të cilëve janë paraqitur në ditën e dytë të konferencës.

Ky publikim i përmban fjalimet e panelistëve, konstatimet e punëtorisë dhe konkludimet e konferencës.

*Organizatorët dëshirojnë t'ju falënderojnë të gjithë folësve, moderatorëve dhe pjesëmarrësve për kontributin e tyre pozitiv. Autorët marrin përgjegjësinë e plotë për opinionet dhe qëndrimet e tyre të paraqitura. Pikëpamjet e shprehura nuk është e domosdoshme të korrespondojnë me pikëpamjet e Fondacionit Fridrih Ebert.*

Jovan Tegovski, Ambasador, Maqedoni

## **PARANDALIMI DHE SIGURIA NJERËZORE: SFIDAT DHE MUNDËSITË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE VENDEVE TJERA TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË ASPEKT TË AFRIMIT DREJT BASHKIMIT EVROPIAN**

### **I. Hyrje**

Viti 2008 tashmë është cilësuar si shumë i rëndësishëm për klimën globale ndërkombëtare, por edhe për zhvillimet rajonale në vendet e Ballkanit perëndimor. Shumë prej zhvillimeve të këtylla janë të lidhura në një mënyrë ose tjetër me demokracinë dhe sigurinë njerëzore, duke prekur miliona njerëz në mbarë botën. Më lejoni të cek vetëm disa prej tyre:

#### 1. Në skenën ndërkombëtare:

- Zgjedhjet historike në SHBA kanë ngritur shumë pritje individuale dhe kolektive, jo vetëm në SHBA por edhe në mbarë botën, përfshirë edhe Afrikën;
- Kriza globale financiare dhe ekonomike, e shoqëruar me krizën e ushqimit që ka pasoja tejet negative për miliona njerëz dëshmoi që askush nuk mbetet imun ndaj saj;
- Konflikti në Gjeorgji, zhvillimet dramatike në Kongo, Somali dhe të mos i harrojmë sfidat ekzistuese si ndryshimi klimatik, që është njëra prej sfidave më të mëdha me të cilat ballafaqohemi, pastaj energjia, mos-përhapja, terrorizmi ndërkombëtar dhe varfëria (pothuajse 3 miliard njerëz ose gjysma e popullatës në botë jeton me më pak se 2 euro në ditë), etj.

#### 2. Në rajonin e Ballkanit perëndimor:

- Pavarësia e Kosovës;
- Pranimi i Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO, progresi i përzier drejt integritimit në BE;
- Fillimi i punës së Këshillit rajonal të bashkëpunimit, si kornizë e re institucionale për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal dhe pronësisë rajonale;

- Zgjedhjet në pjesën më të madhe të vendeve, me të gjitha pasojat pozitive dhe negative;
- Gjendja tejet e ndërlikuar politike në disa vende, etj.

Arsyeja për cekjen e këtyre zhvillimeve dhe sfidave është shumë e thjeshtë dhe gjendet në thelbin e temës së sotme - të gjitha këto kanë ndikim në demokraci dhe siguri njerëzore, pa dallim a vendosen në kontekstin e përkufizimeve të Raportit të UNDP-së të vitit 1994 për zhvillim njerëzor, ku përkufizohen rreziqet në shtatë fusha (ekonomike, ushqimore, shëndetësore, të mjedisit jetësor, personale, politike dhe sigurisë së bashkësisë) ose në kontekstin e gjashtë parimeve të Raportit të Madridit të vitit 2007 për Qasjen e BE-së ndaj sigurisë njerëzore, që fokusohet në mbrojtjen e individëve dhe bashkësive, si dhe në marrëdhënien mes lirisë nga frika dhe lirisë nga kërkesat.

Unë besoj që kjo është një arsye domethënëse për përkushtimin e vëmendjes më të madhe dhe investimit të më shumë përpjekjeve në procesin e pasqyrit dhe mishërimit të Konceptit të parandalimit dhe sigurisë njerëzore në veprime konkrete dhe praktike politike, në të gjitha nivelet - atë ndërkombëtar, nacional dhe posaçërisht nivelin lokal.

Rëndësia e nevojës për ndërmarrjen e hapave domethënës për avancim në këto fusha është edhe më e madhe në rajonin tonë, veçanërisht duke konsideruar që mes tjerash:

- rajoni është pjesë përbërëse e Evropës, të cilit gjithashtu i është dhënë perspektiva evropiane;
- të gjitha vendet e rajonit kanë lidhje institucionale me BE (ndonëse gjenden në faza të ndryshme) dhe të gjitha e ndajnë vizionin dhe qëllimin e njëjtë - anëtarësim të plotë në BE, që do të thotë se gjatë procesit të gjatë dhe të dhembshëm të afrimit drejt BE-së (nënshkrimit dhe implementimit të MSA-së, marrjes së statusit të kandidatit, hapjes dhe përmbylljes së negociatave të anëtarësimit, madje ndoshta edhe ratifikimit të marrëveshjeve të anëtarësimit) ato duhet t'i përmbushin kushtet e nevojshme dhe t'i plotësojnë kriteret e caktuara, duke marrë parasysh që shumica e kërkesave janë në lidhje të drejtpërdrejta ose indirekte me demokracinë dhe sigurinë njerëzore, të drejtat e njeriut dhe zhvillimin njerëzor. Për ta dhënë pasqyrën e qartë - të gjitha janë pjesë qenësore e kriterëve më të rëndësishme të Kopenhagës - atyre politike;
- klima aktuale e sigurisë në Evropë është një arsye e fuqishme për konsolidimin dhe përforcimin e reformave në Ballkanin perëndimor.

## **II. Strategjia e zgjerimit të KE-së dhe sfidat kryesore në 2008-2009**

Javën e kaluar, KE i ka prezantuar dokumentet e Pakos së zgjerimit, me qëllim të shënimit të arriturave dhe mangësive në procesin reformues të vendeve të rajonit, në procesin e implementimit të tyre drejt BE-së. Kjo pako përbëhet nga:

- Strategjia e zhvillimit dhe sfidat kryesore 2008-2009, dhe
- raportet individuale të progresit për shtetet e Procesit të stabilizim-asociimit, plus Turqia.

Vlerësimi i përgjithshëm për Ballkanin perëndimor e ka konfirmuar progresin e shënuar, që megjithatë nuk është i njëjtë në të gjitha vendet. Njëherazi, janë cekur sfida të ndryshme të cilat mund të ndikojnë në sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. Si sfida më të rëndoma janë cekur nevoja për një përforsim përmbytësor të procesit reformues dhe pajtimit, ndërtimit të shtetit, konsolidimit të institucioneve, qeverisjes më të mirë, krijimit të shërbimit administrativ më profesional, të paanshëm dhe llogaridhënës, zbatimit të ligjit në sistemin gjyqësor dhe luftës së korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbindërtimit të dialogut politik dhe frymës së kompromisit (përfshirë çështjet etnike), papunësinë, inflacionin, deficitet aktuale të bilancit, etj.

Vëmendje e posaçme i është dhënë marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal, si çështje kyçe në avancimin drejt anëtarësimit në BE, duke rikujtuar që pothuajse të gjitha vendet e rajonit kanë probleme të pazgjdhura bilaterale me fqinjët e tyre. Rekomandimi në këtë drejtim është shumë i përpiktë dhe i qartë - zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve mbetet prioritet për të gjitha palët.

Këshilli i posathemeluar i bashkëpunimit rajonal pritet të ketë rol të rëndësishëm dhe aktiv në trajtimin e shumë sfidave të këtilla, posaçërisht përmes identifikimit dhe mbështetjes së projekteve të ndryshme zhvillimore rajonale, të dakorduara bashkërisht në pesë fushat e aktiviteteve me prioritet - zhvillimi ekonomik dhe social, infrastruktura dhe energjia, punët e brendshme dhe drejtësia, bashkëpunimi në siguri dhe ndërtimi i kapitalit njerëzor, që kontribuon në përforsimin e demokracisë, parandalimit dhe sigurisë njerëzore.

Nga ana ime, dëshiroj ta theksoj rëndësinë e pjesëmarrjes së shtuar të organizatave të shoqërisë civile në tejkalimin e vështirësive dhe problemeve të përbashkëta në shumë fusha të cekura, veçanërisht në ato që lidhen drejtpërdrejt me parandalimin dhe sigurinë njerëzore.

### III. 2008 - Raporti i Komisionit për progresin e Republikës së Maqedonisë

3. Nuk kam për qëllim të hy në analizë të thellë të përmbajtjes së Raportit, pas vlerësimeve dhe komenteve të shumta nga përfaqësuesit qeveritarë dhe joqeveritarë gjatë ditëve të fundit. Ajo që do të tentoj është të tërheq një lidhje mes prioriteteve kryesore të Partneritetit për anëtarësim ose 8 kritereve të famshme (benchmark), që me kalimin e kohës janë bërë 9 dhe temës së diskutimit tonë. Pasqyra e shkurtë e vlerësimit të KE-së për kriteret politike e shprehin qartë lidhjen mes demokracisë dhe sigurisë njerëzore:
- Në aspekt të dialogut politik, në reformën e administratës publike dhe politikës anti-korruptive është arrit **progres i caktuar ose i herë pas hershëm**; në Ligjin për polici është shënuar **progres**; në sistemin gjyqësor dhe implementimin e MSA-së është arrit **progres i mirë**;
  - Vërejtja kryesore është dhënë për incidentet e dhunshme dhe parregullsitë serioze gjatë procesit të zgjedhjeve parlamentare, si dhe për mungesën e dialogut politik konstruktiv mes partive kryesore politike dhe aktorëve që ka pasur efekt të kundërt për funksionimin e institucioneve politike.

Një fushë tjetër e interesit të diskutimit tonë, që është pjesë e kritereve politike, është fusha e **të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e pakicave**. Vlerësimi i Raportit cek që vendi ka krijuar kornizë të gjerë institucionale, të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe pakicave, por thekson që nevojiten edhe tjera përpjekje për përmirësimin e implementimit në fusha të ndryshme.

- Në fushën e promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut është arritur **pak progres**;
- Në fushën e të drejtave qytetare dhe politike (parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit dhe lufta kundër mos-ndëshkimit, qasja ndaj drejtësisë, sistemi i burgjeve, shoqëria civile, etj) janë ndërmarrë **disa hapa** dhe në përgjithësi, shteti ka **përparim mesatar**;
- Në pjesën e të drejtave ekonomike dhe sociale (të drejtat e femrave dhe fëmijëve, njerëzve të lëndueshëm dhe me pengesa, të drejtat e punëtorëve, politikat anti-diskriminuese, etj) janë ndërmarrë **disa hapa** dhe në përgjithësi, shteti **pjesërisht** i plotëson kriteret;
- Sa i takon të drejtave të pakicave, të drejtave kulturore dhe mbrojtjes së pakicave, është arritur **progres i caktuar** dhe vendi ka përparim **mesatar**.

Si pasojë e konstatimeve dhe vlerësimeve të përgjithshme të Raportit që vendi nuk i ka plotësuar kriteret politike dhe që vetëm pjesërisht i ka trajtuar prioritetet

kryesore të Partneritetit për anëtarësim, KE nuk ka rekomanduar fillim të negociatave për anëtarësim.

#### **IV. Shënimet përfundimtare**

Është mjaft e qartë që parandalimi, demokracia dhe siguria njerëzore janë pjesë përbërëse e proceseve integruese në shtetet e Ballkanit perëndimor drejt BE-së, njëherazi duke qenë shumë të ngërthyera në Politikën e BE-së për zgjerim. Njëri prej përfundimeve kryesore të Raportit të KE-së të vitit 2008 është dhënë pikërisht në këtë drejtim, duke theksuar që zgjerimi i shërben interesave strategjikë të BE-së për stabilitet, siguri dhe parandalim të konflikteve, me çka kontribuohet në rritjen e mundësive për prosperitet dhe zhvillim.

Republika e Maqedonisë dhe vendet tjera të Ballkanit perëndimor janë në Agjendën e BE-së për zgjerim, por shpejtësia e afrimit drejt BE-së do të varet kryesisht nga implementimi i suksesshëm i kërkesave, nga njëra anë dhe nga zgjidhja e suksesshme e çështjeve të ndjeshme të brendshme të BE-së.

Prapëseprapë, përpjekja kryesore duhet të bëhet nga vendet e rajonit, ku duhet të përfshihet përmirësimi i demokracisë dhe sigurisë njerëzore, jo vetëm përmes përmbushjes së kritereve politike në këto fusha, por edhe përmes pasqyrit të tyre në agjenda konkrete politike, duke përfshirë sa më tepër aktorë qeveritarë dhe të shoqërisë civile.

Sfidat me të cilat ballafaqohen vendet janë shumë të lidhura me demokracinë dhe sigurinë njerëzore - institucionet dhe proceset politike të fuqishme, demokratike dhe përfshirëse, në nivel nacional dhe lokal kanë rëndësi qenësore jo vetëm për parandalimin ose menaxhimin e konflikteve të dhunshme në mënyrë konstruktive, por edhe për përshpejtimin e procesit integrues drejt BE-së. Strategjia e KE-së për zgjerim ka dhënë referencë të fuqishme duke theksuar që "viti i ardhshëm do të jetë qenësor për trajtimin e sfidave në Ballkanin perëndimor. Progresi i shteteve të Ballkanit perëndimor drejt anëtarësimit në BE mund të përshpejtohet, në qoftë se i plotësojnë kushtet e nevojshme". Në këtë drejtim, arsyeja kryesore për shpresën nuk duhet të lidhet me natyrën e këtyre sfidave, por me shpejtësinë dhe dinamikën e përgjigjes.

Trpe Stojanovski, MARRI Qendra Rajonale, Maqedoni

## **PARANDALIMI DHE SIGURIA NJERËZORE: DREJT AGJENDËS SË PËRBASHKËT**

Me ndryshimin e shoqërisë, ndryshon edhe ekonomia, kultura, siguria, si dhe mënyra e jetës. Shtetet dhe kulturat orientohen çdo herë e më tepër ndaj njëra-tjetrës, kufijtë administrativë fshihen, migracioni shfaqet në forma të reja, kurse këmbimi i lirë i mallrave, vlerave dhe njerëzve është realitet. Por, kjo i rrit edhe sfidat, veçanërisht ato të sigurisë njerëzore. Sistemet nacionale të sigurisë së vendeve të Ballkanit perëndimor edhe më tej janë në vijim të procesit të reformës dhe zhvillimit. Ato janë të lëndueshme ndaj sfidave të brendshme, siç është sundimi i të drejtës, ballafaqimi me korrupsionin dhe krimin e organizuar, por edhe me kërcënimet globale. Sistemet e sigurisë reformohen duke e respektuar komponentën e integritetit euro-atlantik, përfshirë edhe kornizat e bashkëpunimit rajonal, duke synuar dhënien e kontributit për realizimin më efikas të luftës kundër rrjeteve ndërkombëtare kriminele, përmes orientimit drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-së dhe duke pritur integrim më të shpejtë të sigurisë, me çka shijohen edhe përfitimet e sigurisë më të madhe personale dhe kolektive. Integrimi në sistemet globale të sigurisë, krahas përplasjeve historike në Ballkan, moskuptimeve dhe kundërshtimeve, si dhe perceptimeve të sigurisë dhe kuptimeve të rëndësishme të normës juridike (sipas së cilës ligji serb dhe fermi turk zgjasin tre ditë - pastaj vazhdohet me të vjetrën), duket shpresëdhënëse për banorët e rajonit, si një lloj i dritës në fund të tunelit, që me ndihmën e BE-së më në fund do të braktisen format e fragmentuara të mendimeve filozofike dhe do të miratohet forma evropiane. Ndonëse këto janë dëshirat ekzistuese, arritja në këtë nivel është diçka tjetër në kohën e sotme.

Kërcënimet e reja nga krimi e testojnë politikën e BE-së dhe të arriturat e saj në fushën e integritetit dhe zgjerimit. Terrorizmi, krimi i organizuar, kriza financiare, problemet sociale dhe tensionet etnike krijojnë pasiguri dhe kërcënim për sigurinë e individit. Në ndërkohë, mekanizmat e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë (veçanërisht në fushën e krimit tejkuftar) zhvillohen me kujdes dhe me shpejtësinë e kushtëzuar nga vendimet politike - kryesisht ngadalë.

Në bashkësitë e tyre, qytetarët kërkojnë shërbim më të mirë, me orientim më të madh drejt nevojave të tyre. Ata presin transparencë më të madhe të institucioneve

shtetërore, që do të rezultojë me profesionalitet më të lartë, me ngritje të efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve kompetente, inkorporim të veglave të menaxhimit, besim dhe kënaqësi më të madhe të qytetarëve për punën e institucioneve shtetërore, të shprehur përmes mendimit publik.

Lëvizshmëria më e madhe dhe qarkullimi i qytetarëve përtej kufijve shtetërorë kufizohet nga kalimi më i shpejtë i kontrollit kufitar dhe procedurës më të thjeshtë administrative, si dhe parandalimit më të lartë dhe mbrojtjes nga krimi, mashtrimeve dhe sigurisë më të lartë. Sfidat e lidhura me krijimin e parandalimit më efikas dhe sigurisë njerëzore i promovojnë fuqishëm teknikat e këmbimit dhe deponimit të më tepër veçorive personale, siç janë të dhënat biometrike, si dhe imponimin e teknologjive të reja dhe digjitale të ruajtjes dhe kërkimit të dhënave, që duhet të rezultojnë me nivel më të lartë të parandalimit dhe luftë më efektive kundër terrorizmit, korrupsionit, krimit të organizuar dhe migracionit jolegal. Kuptohet, tendenca për deponimin e veçorive individuale biologjike në bazat shtetërore të dhënave do të imponojë rregulla të reja të jetës së njeriut.

Këto zgjidhje teknologjike janë të rëndësishme në ndërtimin e politikave për parandalim cilësor dhe për sigurinë njerëzore. Por, ajo është edhe pikënisje për zbulimin e veprave penale, në rastet kur parandalimi nuk ka funksionuar, kur janë shkelur vlerat e njerëzimit dhe kur është shkaktuar pasoja nga vepra e kryer penale ose krimi. Duke qenë në partneritet me institucionet tjera kompetente për zbatimin e ligjit, kapaciteti i krim-policisë, që mbështetet në hulumtimin dhe analizën kriminalistike, duhet ta zbulojë çdo rast kur parandalimi është shthurur dhe kur është shkaktuar pasoja kriminale.

Normat e reja e mundësojnë inkorporimin e teknikave të reja për bashkëpunim tejkuftar (dypalësh dhe shumëpalësh), trajnim të përbashkët të efektivave policore, si dhe inkorporimin e procedurave për bashkëpunim në nivel strategjik, operativ dhe taktik.

Qytetarët kërkojnë dhe presin që institucionet kompetente shtetërore çdoherë e më tepër t'i njohin nevojat e tyre dhe që do ta shfrytëzojnë këtë si bazë për zhvillimin e shërbimit të tyre dhe për rritjen e efikasitetit të luftës kundër krimit, që do të rezultojë me aparat më të lirë shtetëror. Disa prej kërkesave të këtilla mund të implementohen më lehtë, por disa tjera mund të shkaktojnë shqetësim, frikë ose rezistencë brenda institucioneve kompetente. Implementimi i disa kërkesave mund të rezultojë me tensione jo vetëm në organizatat e sigurisë, por edhe tek qytetarët dhe institucionet shtetërore.

Zgjidhja e tensioneve nuk është e lehtë, meqë secila palë ka argumente që meritojnë të respektohen. Reformat dhe zhvillimi organizativ prekin çështje sensitive të statusit, të lidhura me identitetin organizativ dhe që mund ta

ballafaqojnë organizimin me pyetje të rëndësishme për stabilitetin dhe sigurinë e saj.

Më të ndjeshme janë këto fusha:

- A. Identiteti i organizatës;
- B. Profesionalizmi dhe trajnimi;
- C. Organizimi dhe menaxhimi;
- D. Integrimi ndërkombëtar.

Përgjigjet e mundshme lidhen me sfidat e cekura në vijim:

- Cili është roli i strukturave të sigurisë (policisë) në bashkësi? Të jetë servis? Organ ekzekutiv? Organ i mbrojtjes? Mjet represiv? Institut për zbatimin e vullnetit politik të oligarkisë? Shtet në shtet? Luftëtar kundër krimit? Ose prej gjithçka nga pak?
- Cilës pjesë të shoqërisë i shërbejnë strukturat e sigurisë, përfshirë edhe policinë? Qytetarëve? Shtetit? Individëve? Grupeve sociale? Bashkësisë lokale? Partive politike? Vetes? Ose vlerave si e mira publike, sundimi i të drejtës, liria, siguria, të drejtat e njeriut?
- Cilat detyra duhet të mbesin si kompetenca të organeve shtetërore dhe cilat mund të privatizohen, përmes aktiviteteve të filluara të reformës?
- Në çfarë mënyre mund të kenë legjitimitet reformat e sektorit të sigurisë, brenda institucioneve dhe bashkësisë? Si do të sigurohet përkrahja e mjaftueshme lokale, ku ndryshimet nuk do të përkrahen vetëm nga strukturat e brendshme, por edhe nga elita politike dhe qytetarët? Cilat argumente mund ta arsyetojnë reformën dhe a do të jenë ato të kuptuara dhe të pranuar?
- Si do të ruhet baraspesha mes sigurisë dhe lirisë? A do të arsyetohet aplikimi i shtuar i teknikave të përcjelljes dhe kontrollit me kërcënimet nga krimi dhe terrorizmi? A mbledhin informata të tepërta agjencitë e sigurimit/policisë për individët, me çka uzurpohen pa të drejtë disa të drejta qytetare? A shfrytëzohen kërcënimet nga terrorizmi dhe krimi për krijimin e shtetit policor nga shërbimet e sigurimit, hap pas hapi, pa e kërkuar askush këtë? A mund të kenë liri të vërtetë njerëzit që ndihen të rrezikuar nga krimi ose kërcënimet terroriste?
- Cili është niveli i nevojshëm i arsimit të efektivit policor? A është profesion ose zanat puna policore? A është pak i trajnuar dhe pak i paguar efektiv policor i cili ecën rrugëve, ose është i trajnuar mirë me shpërblim adekuat?
- Si mund të harmonizohen kërkesat e ndryshme, si kërkesat për specializim të luftës kundër krimit të organizuar me nevojat themelore për sigurimin e

objekteve qeveritare? A do t'i përgjigjet të gjitha profileve të efektivave policore lloji i njëjtë i trajnimit, me të cilin do t'i përgjigjen të gjitha sfidave?

- Si reagojnë shërbimet e sigurisë/policisë ndaj dallimeve të shtuara kulturore dhe etnike brenda bashkësisë? Si integrohen anëtarët e pakicave kulturore, fetare dhe etnike në polici? Si mund të zgjidhet konflikti mes homogjenes dhe të ndryshmes duke mos përdorë forcë?
- Si mund të organizohet dhe menaxhohet bashkëpunimi tejkufitar në nivel cilësor? Pse nuk është arritur kjo deri tani? Cili është roli i sovranitetit nacional në kohën e globalizimit të zgjeruar dhe internacionalizimit të krimin? A mund të zbatohet ligji në territorin e një vendi nga policia e vendit tjetër? A mund të arrestohet qytetari në vendin e tij nga ndonjë polic i vendit tjetër?

Petra Bläss-Rafajlovski, Këshilltare seniore për bashkëpunim parlamentar, Gjermani

## **DIMENSIONI PARLAMENTAR I PARANDALIMIT DHE SIGURIA NJERËZORE**

*Parlamentet luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e parandalimit dhe sigurisë njerëzore, në pasqyrimin e konceptit të sigurisë njerëzore në veprimet konkrete politike dhe hapat e dukshëm qenësorë.*

Për ilustrimin e kësaj teze, fillimisht duhet të kuptohet detyra themelore e kësaj shtylle të rëndësishme në shoqëritë demokratike - deputetët janë përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve të tyre. Ata duhet ta hartojnë dhe shqyrtojnë legjislacionin dhe ta aprovojnë buxhetin. Parlamenti duhet t'i mbikëqyrë politikat qeveritare dhe ta realizojë funksionin e vendosjes së agjendave në politikën e përditshme.

Së dyti, duke qenë përfaqësues të popullit, deputetët kanë pozitë jashtëzakonisht të mirë për kuptimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për shumë çështje komplekse, të cilat shpesh herë e nxisin konfliktin. Përmes lidhjeve të ngushta me votuesit, ata çdo herë duhet të jenë të vetëdijshëm për gjendjen në terren.

Së treti, deputetët kanë mundësi t'i shtyjnë agjendat politike drejt parandalimit të konflikteve dhe sigurisë njerëzore, kryesisht me qëllim të përforcimit të legjislacionit të lidhur me çështjet e sigurimit njerëzor, por që nuk kufizohet vetëm në ato.

Së katërti, shfrytëzimi i mekanizmave dhe procedurave ligjore për kahëzimin e vullnetit dhe burimeve politike drejt parandalimit të konflikteve dhe sigurinë njerëzore është një prej kërkesave të mundshme nga puna e deputetëve.

Biseda për pasqyrimin e konceptit të sigurisë njerëzore në vepra konkrete politike e mundëson krijimin e vështrimit të deputetëve si përfaqësues të zgjedhur, ligjvënës me fuqi buxhetore, si dhe vështrimi i tyre në kapacitetin e mbikëqyrësit të aktiviteteve qeveritare dhe përcaktuesit të agjendës politike. Deputetët nuk janë vetëm politik-bërës dhe ligjvënës në fushën e sigurisë njerëzore, por ata janë edhe komunikues dhe tellallë të rëndësishëm në shoqëritë demokratike.

## **Deputetët si politik-bërës**

Si politik-bërës, deputetët përfshihen në zhvillimin e strategjive më të gjera të sigurimit dhe paqeruajtjes në vendet e tyre. Ata kanë rol qenësor në procesin e raportimit, posaçërisht në aspekt të mekanizmave të shqyrtimit. Deputetët kanë mundësi të marrin pjesë në veprimet diplomatike parandaluese përmes të a.q. "diplomaci parlamentare". Detyra kyçe e Parlamentit është mbikëqyrja e veprimeve të ekzekutivit në çështjet e sigurisë, në kuptim të gjerë. Koordinimi i fuqishëm i punës së komiteteve parlamentare në fushën e mbrojtjes, punëve të jashtme, politikës së sigurisë, zhvillimit, ekonomisë, çështjeve sociale dhe gjinore në aspekt të përgjithshëm dhe posaçërisht në kuptim të çështjeve të sigurisë njerëzore është sfidë e madhe. Deputetët si politik-bërës duhet të ushtrojnë presion të fuqishëm tek qeveritë qendrore për zhvillimin e strategjive paqëruajtëse të avancuara. Ata kanë mundësi ta përfaqësojnë idenë e pranimit dhe implementimit të "Përgjegjësisë për mbrojtje" në praktikë, ata gjithashtu duhet ta garantojnë funksionimin e gjykatave të pavarura në mbajtjen e baraspeshës mes sigurimit nacional dhe njerëzor dhe lirive individuale. Deputetët duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme procesit nacional të raportimit, posaçërisht mekanizmave të shqyrtimit dhe përfshirjes së palëve të interesuara nga shoqëria civile. Mbikëqyrja e veprimeve të ekzekutivit dhe vëzhgimi i implementimit të buxhetit janë detyrat kyçe të parlamentit. Sfidë kryesore me të cilat ballafaqohen deputetët është mbikëqyrja e punës së forcave të sigurisë. Meqë siguria njerëzore është çështje komplekse dhe ka qasje që ndërlihet me fusha të ndryshme, koordinimi më i mirë dhe më i fuqishëm i politikës së jashtme, mbrojtjes, zhvillimit, barazisë gjinore dhe asaj ekonomike, është parakusht për përqendrim shumë më efektiv në diplomacinë parandaluese. Në fund, përkrahja parlamentare përmes "diplomacisë parlamentare" çdoherë duhet të qëndrojë në mbështetje të veprimeve diplomatike.

## **Deputetët si komunikues**

Si komunikues, deputetët janë aktorë kyç në ngritjen e vetëdijes publike për çështjet e sigurimit njerëzor. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të shpjegohet nevoja dhe rëndësia e tyre dhe e barazisë gjinore në këtë kuptim. Politikanët kanë mundësi t'i trajtojnë të gjithë faktorët që kontribuojnë në konflikt, si dhe ta ripërcaktojnë debatin tradicional të sigurimit drejt qasjes më gjithëpërfshirëse. Ata kanë mundësi ta nxisin definimin më të gjerë të sigurimit, me perspektivë më të fuqishme gjinore dhe njerëzore me qasje të sundimit të të drejtës. Deputetët janë në pozitë për ngritjen e vetëdijes për çështjet e sigurimit njerëzor dhe kuptimin për ato, sipas definimit të UNDP-së. Sfidë e radhës është ngritja e vetëdijes së mediave dhe opinionit publik, që të kuptohet se parandalimi i konflikteve dhe siguria njerëzore janë interesa thelbësorë nacionale. Më tej, në agjendën politike gjendet

edhe përqendrimi i vëmendjes tek nevoja për veprime efektive të diplomacisë parandaluese, si dhe ngritja e vetëdijes për çështjet e sigurisë njerëzore. Deputetët kanë mundësi të posaçme për trajtimin e sigurisë njerëzore përmes shqyrtimit të gjitha formave aktuale të pasigurisë globale në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, njerëzore dhe të mjedisit jetësor. Duhet mbajtur mend që qasja për sigurinë njerëzore duhet ta merr parasysh edhe perspektivën gjinore. Njëherazi, në komunikimin e çështjeve të sigurisë njerëzore duhet të pranohet edhe ekzistimi i lidhjes mes sigurisë, zhvillimit, të drejtave të njeriut dhe sigurimit social. Gjatë ballafaqimit me vlerat dhe parimet universale duhet të pranohet fakti që demokracia, sundimi i të drejtës dhe të drejtat e njeriut janë në ndërlidhje dhe kushtëzim të ndërsjellë. Në çdo rast, faktorët që kontribuojnë në konfliktet e dhunshme si efekte të ndryshimeve klimatike dhe varfërisë duhet të trajtohen në mënyrë sistematike.

## **Deputetët si ligjvënës**

Përfaqësuesit e zgjedhur janë përgjegjës për kornizën ligjore të sektorit të sigurisë, sistemit gjyqësor dhe zbatimit të drejtave të njeriut. Gjatë procesit të ligjvënies, çdo herë duhet të mbahet baraspesha mes sigurisë nacionale dhe njerëzore dhe lirive individuale. Përkushtimet ndërkombëtare duhet të zbatohen në të gjitha rastet. Gjatë realizimit të fuqisë buxhetore të parlamentit, ekziston mundësia e krijimit të pikave konkrete buxhetore për sigurinë njerëzore. Në përgjithësi, deputetët kanë mundësi ta nxisin legjislativën qenësore mbi sigurinë njerëzore dhe ta përmirësojnë kornizën politike për lehtësimin e veprimit parandalues. Ata duhet ta krijojnë bazën ligjvënëse për strukturat nacionale të parandalimit të konfliktit. Në këtë aspekt, vëmendja kryesore gjendet tek reforma e sektorit të sigurisë dhe sistemit gjyqësor. Fuqia ligjvënëse e deputetëve e mundëson miratimin e ligjeve me të cilat lejohet baraspesha mes sigurisë nacionale, asaj njerëzore dhe lirive individuale. Nevojitet edhe miratimi i legjislationit efektiv anti-terrorist, sipas instrumenteve dhe përkushtimeve të pranuar ndërkombëtare. Parlamenti duhet t'i miratojë ligjet që e garantojnë të drejtën e pakicave etnike dhe fetare, duke i identifikuar të gjitha llojet e shtypjes dhe duke paraparë sanksione përkatëse. Duhet të mbahet në mend që legjislationi duhet të vlerësohet rregullisht, me fokus special në sigurimin e përputhjes me sigurinë nacionale dhe lirinë individuale. Së këndejmi, të gjitha masat që e kufizojnë lirinë personale duhet të shqyrtohen në imtësi, ku nevojitet edhe krijimi i mekanizimeve që e sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut. Ligjvënësi duhet ta përfaqësojë idenë e dedikimit të resurseve nacionale për parandalim, përmes artikujve buxhetorë për përmirësimin e kapacitetit dhe strukturës së aktiviteteve për parandalimin e konflikteve. Në fund, deputetët duhet të fokusohen në implementimin e obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe lirinë personale, veçanërisht në ratifikimin e përkushtimeve ndërkombëtare dhe protokolleve tjera opcionale.

## **Perspektiva gjinore**

Parlamentet mund të luajnë rol qenësor në promovimin e përfshirjes së plotë dhe aktive të femrave në çështjet e paqes dhe sigurisë njerëzore, si dhe në përfaqësimin e idesë së implementimit të plotë të Rezolutës 1325 të OKB-së për femrat, paqen dhe sigurinë. Ekziston nevoja e fuqishme për mbikëqyrje parlamentare të çështjeve të femrave, paqes dhe sigurisë. Për këtë arsye, përmirësimi i njohurisë së deputetëve për çështjet e paqes dhe sigurisë njerëzore të fokusuara në gjini, posaçërisht ato që lidhen me dhunën gjinore, duhet të përforcohet edhe më tej. Avancimi i kapacitetit parlamentar për përfshirjen gjinore në funksionet qenësore e përfshin edhe buxhetimin, si qasje afatgjate. Pjesëmarrja e femrave në trupat vendim-marrëse si komitetet parlamentare për mbrojtje dhe siguri duhet të rritet edhe më tej. Parlamenti mund ta lehtësojë formulimin e politikave të sigurisë me përfshirje të aspektit gjinor. Programi i këmbimit të deputeteve të Evropës juglindore, të organizuar nga Grupi punues i Paktit të Stabilitetit për çështje gjinore ka pasur sukses në vendosjen e debatit mbi sigurinë njerëzore në agjendën e punëtorive rajonale dhe vijimeve në nivel nacional, duke e bërë këtë qasje komplekse më të dukshme për deputetet.

## **Mangësitë dhe kërkesat e përgjithshme**

Deputetët mund të ndihmojnë në ripërcaktimin e debatit tradicional për politikën e sigurisë nga fokusimi në çështjet e "rënda" të sigurisë në një qasje më gjithëpërfshirëse. Për këtë sfidë afatgjate rekomandohet bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile. Në procesin e ndërtimit të kapacitetit nacional për kulturën e parandalimit të konflikteve, politikanët kanë rol kyç. Në përgjithësi, nevojitet përfshirja më e madhe e deputetëve në avancimin e politikave dhe strategjive efektive nacionale për parandalim. Më tej, duhet të përforcohet obligimi i qeverisë për llogaridhënie ndaj parlamentit, ku nevojitet edhe themelimi i sistemit efektiv të pjesëmarrjes publike në punën e parlamentit, që siguron dialog me deputetët. Përfundimisht, ekziston nevoja për bashkëpunim më të madh rajonal dhe global në nivel parlamentar, të fokusuar në çështjet e sigurisë njerëzore. Me shpresë, nisma e Institutit East-West për Rrjetin parlamentar për parandalimin e konfliktit dhe siguri njerëzore do të jetë e qëndrueshme.

## **Për debatin e punëtorisë janë propozuar këto çështje diskutimi:**

1. Cilat janë zhvillimet lidhur me përfshirjen e deputetëve në zhvillimin, miratimin dhe implementimin e strategjive të gjera nacionale të sigurisë, si dhe debateve?

2. Si pasqyrohet debati për sigurinë njerëzore në debatet dhe vendimet parlamentare?
3. Si marrin pjesë deputetët në trupat speciale të fokusuara në çështjet e gjera të sigurisë?
4. Në çfarë mase pranohet qasja e sigurisë njerëzore nga buxheti?
5. Si është gjendja me implementimin nacional të Qëllimeve të mijëvjeçarit të OKB-së dhe përfshirjes së parlamentit në këtë proces?
6. Në çfarë mase bashkëpunojnë komitetet respektive parlamentare të sigurisë njerëzore në fushat e punëve të jashtme, mbrojtjes, zhvillimit dhe çështjeve gjinore?
7. A ekzistojnë nisma konkrete rajonale të deputetëve që merren me sigurinë njerëzore?

## **Debati i punëtorisë ka rezultuar me këto konstatime:**

### **I. Çka duhet të njihet për debatin e sigurisë njerëzore në rajon?**

1. Vendet e rajonit edhe më tej ballafaqohen me proces të papërfunduar të tranzicionit politik, ekonomik dhe kulturor - të a.q. "shtetet/ekonomitë e dobëta" dhe masat joadekuate të shteteve ekzistuese.
2. Çdo herë duhet të pranohet frustrimi i popullatës për shkak të procesit të gjatë të tranzicionit dhe mungesës së rezultateve të dukshme.
3. Ballafaqimi me qasjen individuale është i vështirë për shkak të mungesës së traditës demokratike.
4. Edhe më tej ekzistojnë deficite në ndërtimin e mendimit publik dhe realizimin e lirisë së mediave.
5. Nevojitet të merret parasysh edhe prania dhe ndikimi i lartë i bashkësisë ndërkombëtare në mbarë rajonin, posaçërisht në Kosovë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.
6. Problemet specifike të secilit vend kanë pasoja në cilësinë e dialogut politik.
7. Rëndësia e marrëdhënieve ndëretnike është me prioritet të lartë në agjendat politike, posaçërisht në vendet shumë-etnike. Modeli i dakordimit mes elitave politike është çështje kyçe në këtë fushë.
8. Bashkëpunimi rajonal në nivel të përgjithshëm dhe veçanërisht në çështjet e sigurisë duhet të përforcohet edhe më tej. Duhet të merren parasysh llojet e ndryshme të bashkëpunimit rajonal në pronësi

rajonale, si dhe bashkëpunimi i organizuar në nivel ndërkombëtar ose ai që funksionon mirë në fushën e krimit të organizuar.

9. Edhe më tej ekziston dallim i thellë mes rëndësisë së madhe dhe përgjegjësisë, si dhe mes kornizës institucionale të parlamentit dhe përmbajtjes dhe rezultateve nga puna e këtij institucioni. Së këndejmi, rankimi i parlamentit është shumë i ulët në sytë e opinionit publik.
10. Siguria njerëzore nuk është e pozicionuar lartë në agjendën politike.
11. Paradigma e sigurisë ka ndryshuar nga aspekti i fuqishëm ushtarak në një perspektivë më të gjerë.

## **II. Nevojat e përgjithshme për ballafaqimin me çështjet e sigurisë njerëzore:**

1. Ballafaqimi me çështjet e sigurisë njerëzore, perspektiva globale krahas jetës së përditshme duhet të merret parasysh në të gjitha rastet.
2. Nevojitet implementimi i parimit themelor të demokracisë - prej poshtë kah lartë.
3. Ekziston nevoja për koordinim më të fuqishëm dhe më efektiv të politikave, të fokusuara në sigurinë njerëzore, si dhe e trupave të përbashkëta që merren me këtë çështje.
4. Bashkëpunimi rajonal duhet të mbetet si prioritet i agjendës, veçanërisht për shkak të çështjeve të sigurisë që mund të zgjidhen vetëm në nivel rajonal.
5. Siguria personale duhet të jetë bazë e përhershme për veprimet politike.
6. Sistemit gjyqësor i nevojiten reforma esenciale, sipas standardeve ndërkombëtare.
7. Palëve lokale duhet t'i jepet më tepër përgjegjësi dhe më shumë nisma.
8. Caktimi i agjendës politike duhet të bazohet çdo herë në nevojat e qytetarëve të rëndomë.

## **III. Lista e detyrave për deputetët:**

1. Trajnimi i ngritjes së vetëdijes për ballafaqimin me dokumentet ndërkombëtare, përkushtimet dhe mekanizmat e OKB-së, me qëllim të shfrytëzimit të tyre sa më efektiv në veprimin ditor politik.
2. Garantimi i ingjercave më të shumta dhe fokusit më të gjerë të komiteve parlamentare.

3. Zhvillimi i aftësive për përcaktimin e agjendave politike në bazë të proceseve buxhetore.
4. Përforcimi i fuqisë buxhetore të parlamentit, veçanërisht të garantimit të kontrollit efikas të fuqisë dhe kontrollit.
5. Fuqizimi i llogaridhënies së deputetëve dhe parlamentit.
6. Tejkalmi i mungesës së kuadrit të kualifikuar parlamentar, në veçantë mungesave me të cilat ballafaqohen komitetet, që janë zemra e punës së parlamentit.
7. Përforcimi i këmbimit dhe trajnimit rajonal të deputetëve dhe kuadrit, që do të fokusohet në çështjet e sigurisë njerëzore.

Tome Sandevski, Instituti për zhvillim dhe paqe, Universiteti Duisburg-Esen,  
Gjermani

## **PËRMBLEDHJE E KONSTATIMEVE TË PUNËTORISË "PARANDALIMI DHE SIGURIA NJERËZORE - INTEGRIMI I AGJENDAVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME"**

### **Hyrje**

Diskutimi gjatë punëtorisë për parandalimin dhe sigurinë njerëzore i ka trajtuar këto pyetje: Si mund të implementohet norma e parandalimit dhe koncepti i sigurisë njerëzore në agjendat konkrete politike? Cilat janë vlerat e përbashkëta dhe parimet themelore pas këtyre dy koncepteve? A ekziston koherencë ose divergjencë në zbatimin e parandalimit dhe qëllimeve të sigurisë njerëzore?

Prezantimi i konstatimeve të punëtorisë është i ndarë në tre pjesë. Pjesa e parë përqendrohet në sfidat konceptuale të grupit të parandalimit/sigurisë njerëzore. Pjesa e dytë i trajton agjendat e brendshme: Çka janë agjendat e brendshme? Cilat çështje janë të rëndësishme për sigurinë njerëzore në Ballkan? Pjesa e tretë ka të bëjë me agjendat e jashtme: Cila është ndërlidhja mes shteteve të Ballkanit dhe faktorëve të jashtëm? Cilat janë dallimet mes agjendave të brendshme dhe të jashtme? Në pjesën e fundit jepen implikacionet kryesore të çështjeve të sigurisë njerëzore mbi proceset politike në Ballkan.

### **Rishqyrtimi i parandalimit dhe sigurisë njerëzore**

Diskutimet e kësaj punëtorie kanë qenë tejet produktive dhe kanë treguar që nuk ekzistojnë kundërtënie mes parandalimit dhe sigurisë njerëzore. Megjithatë, koncepti i sigurisë njerëzore ka qenë shumë më i gjerë. Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë diskutuar nëse siguria njerëzore është koncept teorik, në vend të konceptit të politikës. Pjesëmarrësit kanë cekur që në përgjithësi, deri tani nuk është gjetur asnjë përkufizim i pranuar i sigurisë njerëzore. Por, ata i janë referuar raporteve të organizatave dhe komisioneve ndërkombëtare, që janë hartuar mbi këtë koncept. Konceptet dhe kuptimet e ndryshme të sigurisë njerëzore e kanë lejuar interpretimin e tyre.

Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë cekur që parandalimi i konfliktit është koncept i cili tejqëndrohet tek shteti. Gjatë vështrimit të Ballkanit perëndimor, mund të shihet që masat parandaluese që janë marrë nga aktorët e jashtëm janë përqendruar në mbrojtjen e shtetit nga kërcënimet e jashtme dhe dhuna ndëretnike, që ka qenë shumë e kuptueshme duke e pasur parasysh përvojën nga ish-Jugosllavia.

## **Agjendat e brendshme**

Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë dalluar tre nivele të sigurisë njerëzore: niveli rajonal, niveli nacional dhe ai lokal. Ndonëse çështjet e sigurisë njerëzore kanë dalluar sipas niveleve, sfidat e sigurisë njerëzore në Ballkan mund të konstatohen nga të gjithë.

Së pari, papunësia dhe standardet e ulëta ekonomike kanë krijuar probleme sociale dhe politike. Këto çështje kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe të prekshëm në jetën e qytetarëve ballkanas. Së dyti, korrupsioni ka qenë endemik në të gjitha nivelet në Ballkan, duke e dëmtuar kapacitetin e shtetit për sigurimin e shërbimeve të mira, në të gjitha fushat. Njëherazi, është dëmtuar edhe legjitimiteti i politikanëve. Së treti, marrëdhëniet ndëretnike kanë pasur rëndësi kyçe. Trashëgimia e shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste edhe më tej ka mbizotëruar. Së katërti, problemet e lidhura me bashkë-ekzistimin paqësor të grupeve të ndryshme etnike, që ka qenë veçori për mbarë rajonin. Përfundimisht, këto probleme nuk janë kufizuar në kufijtë shtetërorë, por janë zgjeruar në mbarë rajonin. Problemet e njërit vend kanë efekte të drejtpërdrejta në shtetet fqinje.

## **Agjendat e jashtme**

Koncepti i sigurisë njerëzore nuk bazohet në ndonjë traktat ndërkombëtar me obligim ligjor. Megjithatë, komponentet kyçe të koncepteve të ndryshme të sigurisë njerëzore ngërthehen në mënyrë të dukshme në marrëveshjet ndërkombëtare, siç janë Qëllimet e mijëvjeçarit për zhvillim dhe Kriteret e Kopenhagës. Marrëveshjet ndërkombëtare i promovojnë idetë themelore të konceptit të sigurisë njerëzore. Diskutimi ka treguar që mund të jetë e dobishme nëse organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e përdorin nocionin e sigurisë njerëzore në mënyrë më koherente. Për shembull, zgjerimi i Bashkimit Evropian parasheh përcaktime të ndryshme në disa fusha, me qëllim të krijimit të stabilitetit të institucioneve politike dhe ekonomisë, që lidhet drejtpërdrejtë me sigurinë njerëzore. Sidoqoftë, pjesëmarrësit e punëtorisë kanë theksuar që integrimi në organizatat ndërkombëtare nuk ka mjaftuar për arritjen e nivelit më të lartë të sigurisë njerëzore.

Shtetet e Ballkanit perëndimor kanë pranuar ndihmë nga shtetet perëndimore, si dhe ide të sigurisë dhe politike, përfshirë edhe vizionet afatgjate gjatë 15 viteve të kaluara. Megjithatë, zhvillimet e fundit kanë treguar që shtetet ballkanike janë duke e ndryshuar rolin e pranuesit të ndihmës. Disa shtete të Ballkanit kanë kontribuar me trupa dhe personel civil në misionet paqeruajtëse. Më tej, shtetet e Ballkanit perëndimor e kanë përforcuar bashkëpunimin dypalësh mes vete dhe shtetet e treta. Për shembull, shtetet e Ballkanit perëndimor kanë themeluar një qendër për koordinimin më të mirë të aktiviteteve kundër zjarrit.

Sulmet terroriste të 11 shtatorit dhe kriza aktuale financiare ka treguar që shtetet perëndimore nuk janë imune ndaj kërcënimeve të sigurisë njerëzore. Këto zhvillime i kanë treguar Ballkanit që nuk mund të mbështetet përgjithmonë në ndihmën e shteteve perëndimore - vendet ballkanike duhet të jenë të vetëqëndrueshme në kuptim afatgjatë. Problemet si ndryshimet klimatike, ndotja e mjedisit jetësor, papunësia dhe kohezioni social mund të jenë problemet më të spikatura në ardhmëri. Herët ose vonë, Ballkani do të duhet të ballafaqohet vetë me kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore.

Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë argumentuar që koncepti i sigurisë njerëzore mund të jetë alternativë e dobishme për të drejtat e njeriut dhe të pakicave. Ata e kanë theksuar rastin e Turqisë ose Greqisë, që refuzojnë ta njohin shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë theksuar që organizatat ndërkombëtare është dashur ta shkelin sovranitetin e shteteve me qëllim të realizimit të drejtave të njeriut dhe pakicave. Gjatë debatit për përgjegjësinë e mbrojtjes është theksuar pyetja se kur duhet të ndodh intervenimi.

## **Implikacionet për proceset politike**

Disa pjesëmarrës të punëtorive kanë cekur që koncepti i parandalimit të konflikteve është i përqendruar tek shtetet, për dallim nga sfidat kryesore afatgjate, siç janë ndryshimet klimatike, krizat financiare dhe terrorizmi, që përqendrohen tek njeriu. Problemet mund të trajtohen përmes periudhave më të gjata kohore, ndonëse proceset politike janë çështje afatshkurta.

Pjesëmarrësit e punëtorisë kanë mbështetur idenë që aktorët e brendshëm dhe të jashtëm duhet të fokusohen në ndërtimin e kapacitetit tek politikanët dhe qytetarët - politikanët duhet t'i marrin informatat dhe aftësitë e nevojshme për ballafaqimin me kërcënimet për sigurinë njerëzore. Qytetarët, nga ana tjetër, duhet ta zhvillojnë kuptimin e fuqishëm të shtetësisë, me qëllim që të ndikojnë në procesin e politik-bërjes dhe vendim-marrjes. Qytetarët duhet të organizohen vetë për krijimin e masës kritike, që do të ketë mundësi të ndikojë mbi politikën.

Lidija Georgieva, Qendra për parandalim dhe vlera evropiane, Maqedoni

## **DEMOKRACIA DHE SIGURIA NJERËZORE INTEGRIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR DHE AGJENDA LOKALE POLITIKE**

### **Përmbledhje e shkurtër dhe shënimet përfundimtare**

Marrë në përgjithësi, demokracia, siguria njerëzore dhe zhvillimi janë koncepte dhe praktika që ndërlidhen mes vete. Kjo ndërlidhje ka filluar të njihet dhe theksohet në fillimin e viteve të nëntëdhjeta, fillimisht si një koncept i ri në agjendën e politikës ndërkombëtare, kohë më parë se të përdoret si frazë e bindjes në kuptim akademik dhe të hulumtimit. Vendosija e sigurisë njerëzore si çështje me rëndësi të barabartë me sigurinë e vendit, kërkon hulumtim paraprak të politikave tradicionale dhe krijimin e politikave, instrumenteve dhe veglave të reja implementuese. Në veçanti kërkohet ndjeshmëria politike për kohën dhe mënyrën e ballafaqimit me çështjet e sigurisë njerëzore. Në rastin e Ballkanit perëndimor, tranzicioni afatgjatë drejt demokracisë dhe shfaqja e konflikteve të dhunshme i kanë formësuar kushtet që kanë kërkuar ndërhyrje të menjëhershme ndërkombëtare, në emër të sigurisë njerëzore. Humanizimi i sigurisë si proces dhe qëllim është shfaqur në bazë të këtij kuptimi dhe në bazë të tranzicionit afatgjatë të vendeve dhe shoqërive në dy linja: demokracitë tranzicionale bëhen edhe më të ndara në linja sociale, ekonomike, etnike dhe politike, kurse lëndueshmëria e shoqërive dhe qytetarëve rritet dhe komplikohet edhe më tej nga konfliktet e dhunshme. Ndonëse diapazoni i veprimit ka ndryshuar sipas rasteve, përshtypja e përgjithshme është që siguria njerëzore është kuptuar dhe aplikuar në përkufizimin e saj të ngushtë - kryesisht e lidhur me pasojat e konflikteve të dhunshme.

Tendenca që individët ta kenë rëndësinë e njëjtë si edhe siguria e shtetit e ka arritur momentin e shfaqjes dhe njohjes gjatë kuptimit të ngjarjeve në Ballkanin perëndimor. Hulumtimi i lidhjeve mes demokracisë dhe sigurisë njerëzore duhet të fillojë nga niveli konceptual, me qëllim të ekzaminimit të koncepteve aktuale të demokracisë, shtetit post-modern dhe sigurisë njerëzore, si dhe implementimit të tyre në praktikë.

Ky hulumtim duhet t'i ekzaminojë edhe interpretimet e ndryshme të koncepteve dhe praktikave të këtylla në nivel **ndërkombëtar, rajonal, nacional dhe mbi të gjitha - në nivel lokal**, ku kërkohet të paktën qartësimi i kuptimit dhe supozimeve

për sigurinë njerëzore në kontekste të ndryshme. Në veçanti, kërkohet vlerësimi i rëndësisë së sigurisë njerëzore në kushte të shumëllojshme rajonale dhe lokale, ekzaminimi i implementimit të modeleve specifike, mënyra e implementimit të modeleve dhe rezultateve të tyre. Cila është natyra, roli dhe përgjegjësia e vendit në sigurinë njerëzore dhe a mund të bëhen shtetet ndërmjetësues të suksesshëm mes agjendave politike rajonale dhe lokale?

### **Aktivitetet dhe prapavija e projektit**

Përmes këtij projekti, FES dhe Qendra PEV i kanë prezantuar konceptet dhe hulumtimet dhe e kanë realizuar edukimin dhe trajnimin e aktorëve të ndryshëm vendas nga komunat shumë-etnike, përfshirë edhe përfaqësuesit e administratës publike dhe përfaqësuesit qeveritarë dhe joqeveritarë. Pas katër konferencave rajonale dhe disa seminareve për parandalimin e konflikteve, sigurinë njerëzore dhe decentralizimin, FES dhe Qendra PEV vazhdojnë me promovimin e dialogut për vlerat e përbashkëta, sigurinë njerëzore dhe parandalimin e konflikteve së bashku me aktorët lokal, nacional dhe rajonal.

Qëllimet e punëtorisë dhe konferencës janë:

- Elaborimi i krijimit të konceptit të demokracisë dhe sigurisë njerëzore dhe gjendjen e saj aktuale;
- Ekzaminimi i modeleve dhe proceseve të implementimit në nivel rajonal;
- Identifikimi i modeleve lokale dhe adaptimeve të demokratizimit dhe sigurisë njerëzore;
- Identifikimi i shembujve pozitivë dhe sfidave ekzistuese.

Dita e parë e punëtorisë ka përfshirë një sesion hyrës dhe 3 punëtori tematike. Sesioni hyrës i ka trajtuar këto çështje:

- Ekzistimi dhe masa e parandalimit dhe sigurisë njerëzore në proceset integruese rajonale dhe të Republikës së Maqedonisë;
- Parimet dhe vlerat themelore në bazë të cilave pjesëmarrësit mund të marrin qëndrime të përbashkëta ose t'i identifikojnë ato si prioritet;
- Identifikimi i aktorëve kyç dhe mënyra në të cilën mund të implementohet parandalimi dhe siguria njerëzore, në suazat e politikës dhe instrumenteve të aktorëve të ndryshëm;
- Identifikimi i prioriteteve kyçe për agjendën e përbashkët.

Çështjet e lartcekura janë hulumtuar në mënyrë plotësuese gjatë punëtorisë mbi temat në vijim:

**1. Parandalimi dhe siguria njerëzore: Integrimi i agjendës së brendshme dhe të jashtme:**

- Si mund të zbatohen normat e parandalimit dhe koncepti i sigurisë njerëzore, në kuadër të agjendës së jashtme politike?
- Cilat janë vlerat dhe parimet e përbashkëta pas këtyre dy koncepteve?
- Identifikimi i mundësisë për zhvillimin e qasjes prej poshtë-lartë;
- Çfarë lloji i bashkëpunimit ekziston dhe a ka nevojë për krijimin e formave plotësuese?

**2. Dimensionet lokale të parandalimit dhe sigurisë njerëzore:**

- Cilat janë perspektivat lokale për prioritetet dhe nevojat për demokratizim dhe siguri njerëzore?
- Mundësitë dhe sfidat për humanizimin e sigurisë përmes procesit të decentralizimit - kush është i pasigurt dhe pse?
- Detektimi i aktorëve lokal dhe roli i tyre në sigurimin e sigurisë njerëzore;
- Nevoja për krijimin e kapacitetit lokal;
- Përmirësimi i vlerësimit të lëndueshmërisë dhe këmbimi i informatave.

**3. Dimensioi parlamentar i parandalimit dhe sigurisë njerëzore:**

- Roli i parlamentit në promovimin e parandalimit dhe sigurisë njerëzore në agjendën e politikës së jashtme dhe të brendshme;
- Në çfarë mase dhe si promovohet parandalimi dhe siguria njerëzore përmes përkrahjes së reformave demokratike dhe proceseve integruese nga ana e parlamentit dhe komisioneve parlamentare;
- Mundësia për mbështetjen e agjendës së përbashkët përmes koordinimit të politikës së jashtme, zhvillimore dhe të mbrojtjes, si dhe diplomacisë parandaluese;
- Zhvillimi i parimeve për angazhimin e jashtëm për sigurimin e sigurisë njerëzore, në rast të intervenimit;
- Përkrahja e krijimit të pikës buxhetore për financimin e sigurisë njerëzore;
- Bashkëpunimi me deputetët e rajonit për çështjet e lidhura me sigurinë njerëzore;

- Krijimi i kapacitetit për siguri njerëzore përmes bashkëpunimit rajonal, OJQ-ve, edukimit dhe trajnimit.

Në **ditën e dytë** të konferencës ka pasur fjalime nga zyrtarët e FES-it, Qendrës PEV dhe Ministrisë së punëve të jashtme, si dhe nga përfaqësuesit e Ambasadës së Holandës. Ngjarja kryesore ka qenë prezantimi dhe diskutimi mbi konstatimet e punëtorisë, pas së cilës janë prezantuar shënimet përfundimtare.

Kjo konferencë është kontribut i rëndësishëm për dialogun mbi demokracinë dhe sigurinë njerëzore, në aspekt të Ballkanit perëndimor dhe agjendave politike lokale. Rezultatet e pritura janë:

- Theksimi i rritur i demokracisë dhe sigurisë njerëzore;
- Dialogu mes bashkësisë akademike dhe politike, si dhe opinionit të gjerë;
- Përkrahja e vetëdijes publike dhe rëndësia e pjesëmarrjes aktive;
- Përkrahja për alternativat dhe modelet lokale të sigurisë njerëzore;
- Publikimi i raportit të konferencës.

## SHËNIMET PËRFUNDIMTARE

- Dita e parë dhe e dytë e konferencës kanë krijuar mundësi për vazhdimin e përqendrimit dhe për ngritjen e vetëdijes më të lartë për demokratizimin dhe sigurinë njerëzore, si çështje që shfaqen në agjendat rajonale, nacionale dhe lokale. Ekspertët, akademikët, deputetët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë diskutuar për aspektet konkrete të demokratizimit dhe sigurisë njerëzore, duke e theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e modeleve alternative dhe lokale të sigurisë njerëzore;
- Madje edhe paradigma e sigurisë ka pësuar ndryshim përmes zgjerimit dhe avancimit të sigurisë përtej nocionit tradicional ushtarak - siguria njerëzore, si pasqyrim i këtij ndryshimi konceptual dhe politik nuk radhitet shumë lartë në agjendat politike në rajon;
- Dimensioni i parlamentit është i rëndësishëm, për shkak të operacionalizimit të konceptit të parandalimit dhe sigurisë njerëzore, ku kërkohet rol politik aktiv dhe dinamik i deputetëve për çështjet kryesore të parandalimit dhe sigurisë njerëzore, në kornizat e realizimit të funksionit legjislativ dhe të kontrollit. Këtu kërkohet edhe përgjegjësia dhe ndjeshmëria më e lartë politike ndaj koncepteve më njerëzore dhe më etike të të drejtave të njeriut, dinjitetit dhe zhvillimit njerëzor;
- Debati për sigurinë njerëzore në rajon ka disa çështje të emërtuesve të përbashkët, që janë pjesë më tepër ose më pak e rëndësishme e brengës politike dhe debatit publik. Çështjet më urgjente lidhen ose nxiten nga aspektet e cekura në vijim: procesi i papërfunduar i tranzicionit politik, ekonomik dhe kulturor; shtetet/ekonomitë e dobëta dhe mosekzistimi i masave shtetërore; frustrimet e popullatës për shkak të procesit të gjatë të tranzicionit; vështirësia dhe mungesa e ndjeshmërisë për ballafaqim me qasjen individuale, si rezultat i mungesës së traditës; mungesa e mendimit publik dhe lirisë së mediave; ndikimi i lartë dhe përfshirja afatgjate e bashkësisë ndërkombëtare; problemet specifike dhe pasojat ndaj dialogut politik që janë specifike në çdo shtet; specifikat e shteteve shumë-etnike dhe dinamika e marrëdhënieve ndëretnike si çështje e dakordimit politik; llojet e ndryshme të bashkëpunimit rajonal drejt bashkëpunimit të mirëfilltë në pronësi rajonale dhe të organizuar nga brenda në fushën e krimit të organizuar.

- Disa nevoja të përgjithshme janë njohur si udhërrëfyes të rëndësishëm për përforcimin e debatit drejt përqendrimit të vëmendjes dhe zhvillimit të veprimeve për demokratizim dhe siguri njerëzore. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet nevojave në vijim: pasqyrimi i nocionit të perspektivës globale të sigurisë njerëzore krahas nevojave konkrete të jetës së përditshme; implementimi i parimit demokratik prej poshtë-lartë; koordinimi më i fuqishëm dhe trupat e përbashkët të sigurisë njerëzore, gjegjësisht bashkimi i agjendës së jashtme, zhvillimore dhe asaj të sigurisë; përforcimi i bashkëpunimit rajonal për çështjet e lidhura me sigurinë njerëzore dhe njohja e çështjeve rajonale ndër-sektoriale dhe të përbashkëta; konsiderimi i sigurisë personale si bazë; zhvillimi i sistemeve gjyqësore sipas standardeve ndërkombëtare; zhvillimi dhe mbështetja e më tepër nismave dhe përgjegjësive lokale; përcaktimi i agjendës sipas nevojave të qytetarëve të rëndomë.
- Roli i deputetëve si institucion kryesor në operacionalizimin e demokracisë dhe sigurisë njerëzore duhet të përforcohet përmes plotësimit të disa nevojave specifike. Në veçanti, ngritja e vetëdijes për ballafaqimin me dokumentet ndërkombëtare, përkushtimet dhe mekanizmat e OKB-së dhe BE-së, që mund të jenë qenësore për përforcimin e efikasitetit. Gjithashtu, kërkohet edhe avancimi i kompetencave dhe zgjerimi i fokusit të komiteteve parlamentare; përmirësimi i aftësive për përcaktimin e agjendës në bazë të procesit buxhetor; praktikimi i fuqisë buxhetore parlamentare në mënyrë më efektive, si instrument kyç; llogaridhënia e deputetëve dhe parlamentit, tejkalimi i mungesës së kuadrit të komiteteve parlamentare; këmbimi rajonal dhe trajnimi për deputetët dhe nëpunësit.
- Procesi i rimëkëmbjes dhe demokratizimit paskonfliktuoz në Ballkanin perëndimor është specifik për secilin shtet, pas përjetimit të konflikteve komplekse dhe të dhunshme. Megjithatë, të paktën aktorët ndërkombëtarë e njohin sigurinë njerëzore si çështje urgjente, veçanërisht në rastet kur vjen si kërkesë për mbrojtjen dhe sigurinë e civilëve nga dhuna direkte. Siguria e këtyre njerëzore edhe më tej mbetet çështje e rëndësishme në kontekstin e Ballkanit perëndimor, në të gjitha tre nivelet (rajonal, nacional dhe lokal), duke u shfaqur përmes çështjeve të ndryshme. Tani fokusi është i zgjeruar dhe shoqëron forma plotësuese të problemeve sociale, politike dhe ekonomike që ndikojnë dukshëm në gjendjen e sigurisë dhe sigurimit të individëve. Mbase është e dobishme të dallohen agjendat e brendshme dhe të jashtme, me qëllim të krijimit të pasqyrës së qartë për agjendat lokale të brendshme dhe të jashtme.
- Diferencimi mes tre niveleve (rajonal, nacional dhe lokal) është i rëndësishëm për krijimin e pasqyrës së qartë të kontekstit të sigurisë njerëzore, duke marrë parasysh që këto çështje dallojnë sipas niveleve. Prapëseprapë, mund të bëhet

dallimi i një tërësie të sfidave për sigurinë njerëzore në Ballkanin perëndimor: së pari, papunësia dhe standardet e ulëta ekonomike kanë krijuar probleme sociale dhe politike. Këto çështje kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe të prekshëm në jetën e njerëzve në rajon. Së dyti, korrupsioni e pengon kapacitetin e shtetit për sigurimin e shërbimeve të mira në të gjitha nivelet, duke e penguar edhe legjitimitetin e politikanëve. Sfida e tretë e rëndësishme dhe çelësi i stabilitetit dhe sigurisë njerëzore vjen nga marrëdhëniet ndëretnike. Edhe më tej mbizotëron trashëgimia nga shpërbërja e Jugosllavisë socialiste. Në fund, këto probleme nuk përfundojnë në kufij dhe shtete, por shpërndahen në mbarë rajonin. Problemet në një vend kanë implikime të drejtpërdrejta në shtetet fqinje;

- Në mënyrë të ngjashme si agjendat e brendshme, edhe agjendat e jashtme janë komplekse dhe bazohen në prioritete tjera, të cilat janë kontestuese ose të veçanta. Ndonëse koncepti i sigurisë njerëzore nuk bazohet në traktate ndërkombëtare me obligim ligjor, komponentet kyçe të koncepteve të ndryshme të sigurisë njerëzore ngërthehen në mënyrë të dukshme në marrëveshjet ndërkombëtare, siç janë: Qëllimet e mijëvjeçarit për zhvillim dhe Kriteret e Kopenhagës. Përdorimi i nocionit të sigurisë njerëzore në mënyrë më koherente nga institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë mund të jetë mjaft i dobishëm.
- Shtetet e Ballkanit perëndimor kanë pranuar ndihmë nga shtetet perëndimore, si dhe ide të sigurisë dhe politike, përfshirë edhe vizionet afatgjate gjatë 15 viteve të kaluara. Në këtë aspekt, është kyçe që shtetet e Ballkanit perëndimor të zhvillojnë dhe të realizojnë marrëdhënie më aktive mes shteteve të rajonit dhe në drejtim të vendeve perëndimore. Demokratizimi dhe plotësimi i kriterëve të Kopenhagës vështrohet si mënyrë e veçantë për ballafaqimin me çështjet e sigurisë njerëzore. Megjithatë, ekzistojnë disa sfida specifike për vendet e Ballkanit perëndimor në rrugëtimin e tyre drejt evropianizmit.
- Është mjaft e qartë që parandalimi, demokracia dhe siguria njerëzore janë pjesë përbërëse e proceseve të integritit të shteteve të Ballkanit perëndimor drejt BE-së, njëherazi duke qenë mjaft të mishëruara në politikën e BE-së për zgjerim. Një prej përfundimeve kryesore të Raportit të KE të vitit 2008 e ka trajtuar pikërisht këtë aspekt, duke theksuar që zgjerimi i shërben interesave strategjikë të BE-së për stabilitet, siguri dhe parandalim të konflikteve, me çka jepet kontribut për rritjen e mundësive të prosperimit dhe zhvillimit.
- Republika e Maqedonisë dhe vendet tjera të Ballkanit perëndimor janë pjesë e Agjendës së BE-së për zgjerim, por shpejtësia e afrimit drejt BE-së do të varet kryesisht nga implementimi i suksesshëm i kërkesave nga njëra anë dhe nga

zgjdhja e suksesshme e çështjeve të ndjeshme interne të BE-së, nga ana tjetër.

- Sidoqoftë, përpjekjet kryesore i takojnë pjesës së shteteve të rajonit, ku duhet përfshirë përmirësimi i demokracisë dhe siguria njerëzore, jo vetëm përmes plotësimit të kushteve politike në këto fushë, por duke i pasqyruar ato në agjenda konkrete politike, ku përfshihen sa më tepër aktorë qeveritar dhe të shoqërisë civile.
- Ndërlidhja konkrete mes demokratizimit dhe sigurisë njerëzore zhvillohet në nivel lokal, ku demokratizimi lokal është i lidhur në mënyrë të veçantë me procesin e decentralizimit. Në të njëjtën kohë, hapësira lokale është mjedisi kryesor politik ku qytetarët e ndiejnë pa/sigurinë. Problemet dhe pakënaqësitë e lidhura me plotësimin e nevojave dhe prioritetëve të përditshme nuk shfaqen rastësisht. Ato janë të lidhura me të drejtat dhe mundësitë e barabarta për qytetarët, si dhe për grupet e marginalizuara brenda bashkësive lokale.
- Decentralizimi efektiv është qenësor për përf forcimin e kapaciteteve lokale dhe për përfshirjen e bashkësive lokale. Procesi i decentralizimit është shumë më sfidues në mjediset lokale shumë-etnike, ku ekziston edhe nevoja më e madhe për procedura të institucionalizuara për parandalimin e konfliktit dhe ngritjen e vetëdijes për sfidat e sigurisë njerëzore. Me rëndësi janë edhe marrëdhëniet më aktive dhe pjesëmarrëse mes qytetarëve dhe këshillave lokale.
- Marrëdhëniet midis qeverisë qendrore dhe pushtetit lokal vështrohet si forcë shtytëse për çështje të reja të konfliktit, të lidhura me kompetencat, buxhetimin, ndërtimin e kapacitetit, njohjen e prioritetëve, transparencën, etj.
- Aktorët lokal janë partnerët kryesorë në zhvillimin e agjendës së sigurisë njerëzore në nivel lokal. Ekziston edhe nevoja për ngritjen e vetëdijes për rolin e tyre specifik në zhvillimin e agjendës së sigurisë njerëzore në nivel lokal, sipas nevojave dhe prioritetëve të perceptuara. Nevojat tjera lidhen me krijimin e kapacitetit institucional dhe të burimeve njerëzore, me qëllim të rritjes së ndjeshmërisë dhe gatishmërisë së aktorëve lokal ndaj agjendës lokale.
- Midis çështjeve të njohura që lidhen me agjendën e sigurisë njerëzore ceken papunësia, varfëria, përjashtimi nga proceset sociale ose politike, trafikimi me qenie njerëzore, armët ilegale, krimi dhe korrupsioni. Ndonëse të gjithë aktorët janë të vetëdijshëm për sfidat dhe pasojat që rrjedhin nga çështjet e lartcekura, ekziston mungesa e informatave, kapacitetit të pamjaftueshëm dhe vullnetit politik për inicimin e veprimit dhe vendosjen e sigurisë njerëzore dhe parandalimit në agjendën politike lokale.

- Demokratizimi dhe decentralizimi janë procese paralele që duhet të mbështeten në nivel lokal. Decentralizimi si proces duhet të kontribuojë në demokratizimin e bashkësive lokale, veçanërisht atyre që kanë përbërje shumë-etnike dhe shumë-fetare.